



## FUQIZIMI DHE PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË KRUJË

**Çfarë është:** Projekti është nismë modeste për të krijuar një mjedis nxitës për artizanatin tradicional të qytetit të Krujës, duke ofruar një platformë të përshtatshme për të rinjtë që të njohin praktikojnë dhe të zhvillojnë mjeshtëritë e artizanatit tradicional. Specifikisht, kjo nismë do të ofrojë një kamp veror për fëmijët e qytetit të Krujës për të promovuar artizanatin tradicional dhe mësuar praktikimin e mjeshtërive kryesore. Në të ardhmen ata do të jenë qytetarë të përgjegjshëm për trashëgiminë e tyre kulturore.

**Pse kjo nismë:** Artizanati tradicional në Krujë është një burim i jashtëzakonshëm i interesit të turistëve që eksplorojnë kulturën autentike dhe traditën e qytetit duke u kthyer në këtë mënyrë në një nga drejtimet kryesore të ekonomisë lokale, veçanërisht për gratë. Artizanati tradicional ekziston sot, falë praktikave dhe mjeshtërive të transferuara ndër breza, por sfida është e madhe për të siguruar që këto mjeshtëri të vazhdojnë të jenë të gjalla dhe të përhapen tek brezat e ardhshëm. Në përpjekje për të ruajtur dhe transferuar njohuritë dhe mjeshtëritë tradicionale nga një brez në tjetrin, do të

organizohet kampi veror për fëmijë “*Kruja artizanale; e ardhmja është në origjinë*”

**Qendra e Zhvillimit të Artizanatit**  
Qendra menaxhohet nga Grupi i grave artizane të Krujës dhe synon promovimin, ruajtjen dhe zhvillimin më tej të artizanatit tradicional.

**Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD):** beson në rolin e rëndësishëm që kanë gratë dhe vajzat në mirëqenien familjare, komunitare dhe në zhvillimin e përgjithshëm social ekonomik të vendit tone. ANRD është në kërkim të instrumenteve për fuqizimin social dhe ekonomik të grave dhe mbështet artizanatin, punën e dorës, nismat kolektive të grave si alternativa që lehtësojnë sfidat e tyre drejt fuqizimit dhe arritjes së potencialit të plotë të tyre.

**Grupi i Grave Artizane të Krujës**  
bën bashkë 18 artizane të cilat janë organizuar me qëllim lehtësimin e aksesit më të mirë të përbashkët si grup në tregje, duke prodhuar dhe shitur produkte të artizanatit tradicional lokal me standarte të dakortësuara bashkërisht.

*Projekti “Fuqizimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore në Krujë” bëhet i mundur me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.*



# KAMPI VEROR

## KRUJA ARTIZANALE

E ARDHMJA JONË ËSHTË NË ORIGJINË

Kushtuar promovimit të artizanatit tradicional dhe krijimit të një platforme të përshatshme për fëmijët dhe të rinjtë për të njohur, praktikuar dhe zhvilluar mjeshtëritë e artizanatit tradicional krutan.

*Një kamp veror krejt ndryshe nga kampet e tjera tradicionale.*



**Koha kur do të zhvillohet:** 17 - 28 qershor 2024, nga ora 9 deri në orën 12:30

**Kush merr pjesë:** 15 fëmijë të grupmoshës 10 – 14 vjeç

**Çfarë përmban kampi:** punëtori praktike në mjeshtëritë kryesore, vizita në mjeshtër të ndryshëm dhe vende historike që lidhen me artizanatin tradicional, si dhe aktivitete të tjera të lidhura me artizanatin tradicional si konkurse krijimtarie, projekte të përbashkëta dhe panair për të rinjtë për të praktikuar dhe për të shfaqur aftësitë e tyre.

**Ku organizohet:** Qendra e Zhvillimit të Artizanatit Krujë, Pallati i Kulturës “Ibrahim Bërdaku”, Rruga “Vrana Konti”, Qendër, Krujë

**Kush organizon:** Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në bashkëpunim me Grupin e Grave Artizane të Krujës

*Pjesëmarrja në kamp është falas.*

Për të aplikuar skanoni linkun këtu:



SCAN ME

*Jeni të mirëpritur.*